

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-112/13

Prishtinë,
20 nëntor 2014

Në çështjen juridike të:

N. B.

Ankuesi

kundër.

J.H.

Gllgovc/Glogovac

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit i AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur lidhur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/112/2011 (lënda e të regjistruar në AKP me numrn KPA01307), i datës 22 qershor 2011, pas seancës gjyqësore , të mbajtur më 20 nëntor 2014 mori këtë

AKTGJYKIM

1. Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/112/2011 (që i referohet lëndës të regjistruar në AKP me numrin KPA01307), i datës 22 qershor 2011, për shkak se është nxjerrë në mungesë të jurisdikcionit.
2. Hedhet kërkesa e J. H. e regjistruar në AKP me numër KPA01307 për shkak të mungesës së jurisdikcionit.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 29 nëntor 2007 J. H. ,ka depozituar një kërkesë të regjistruara në AKP (KPA01307) në cilësinë e bartësit e drejtës pronësore të ngastrës kadastrale nr.627/2 me kulturë kullosë e klasës së dytë në vendin e quajtur “Livadhi i Begut”, në sipërfaqe prej 0.04.48 ha. Ai kërkon të drejtën e pronësisë të kësaj prone të paluajtshme me kthimin e posedimit dhe regjistrimit në Zyrën e Kadastrit të Komunës së Glogovcit.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij , ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
 - Kopjen e planit të Shërbimit për Kadastër të pronës së Paluajtshme të Komunës së Glogovcit të datës 03.qershor.2003 (organi paralel),
 - Fotokopjen e ekstraktit të fletës së Posedimi nr.67 i Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi i Komunës së Glogovcit i datës 03 qershor 2003. Me këtë ekstrakt të flet posedimit konstatohet se ngastra kadastrale 627/2 është e regjistruar me ½ e pjesës ideale të bashkëpronësisë në emër të E.H. dhe R. H.
 - Fotokopjen e ekstraktit të fletës së Posedimi nr.67 i Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi i Komunës së Glogovcit i datës 03 qershor 2003. Me këtë ekstrakt të flet posedimit konstatohet se ngastra kadastrale 627/2 është e regjistruar me ½ e pjesës ideale të bashkëpronësisë në emër të E. H. dhe R. H.
3. Sekretaria ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronave sipas detyrës zyrtare ka siguruar fletën poseduese të Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi të Komunës së Glogovcit nr.67 i datës 31mars 2009, që është tërësisht identike me fletën poseduese të dt. 03 qershor 2003.
4. Këto prova të theksuara janë verifikuar si të juridikisht të vlefshme nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-ës dhe të njëjtat janë relevante për këtë çështje juridike kontestimore.

5. Në vitin 2010, AKP ka bere njoftimin në lidhje me kërkesën, duke e shpallur kërkesën në Gazetën Njoftuese nr. 3 dhe në Buletinin e Zyrës së Pronës të UNHCR-it. Gazeta dhe Lista i ishin afishuar në Gjykatën Komunale dhe në Kuvendin e Komunës së Glogovcit.
6. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e saj KKPK/D/A/112/11 datë 22.06.2011, ka vendosur që paraqitësit të kërkesës t'i pranohet e drejta e pronës të ngastrës së kërkuar dhe t'i kthehet në ri posedim e njëta ngastër në pjesën ideale të ½ të pronës së kërkuar.
7. Paraqitësi i kërkesës J. H. e ka pranuar vendimin ankimor me 31.tetor.2011. Ndërkaq Nazmi Bucolli të njëjtin vendim e ka pranuar me 29.prill.2012 dhe se njëti ankesën e ka paraqitur me 10.maj.2013.

Pretendimet ankimore:

8. Paraqitësi i ankesës N. B. e kundërshton vendimin e ankimor për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të drejtës materiale si dhe për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore me propozim që të refuzohet kërkesa e J.H. si e pabazuar duke e anuluar vendimin ankimor.
9. Paraqitësi i ankesës pretendon se KPCC nuk është kompetente për të vendosur për këtë çështje juridike, ngase kontesti nuk ka të bëjë me periudhë dhe rrethanat e konfliktit të armatosur në Kosovë në periudhën 1998/1999.Pët të mbështetur pretendimin ankimor ka paraqitur aktvendimin e Gjykatës Komunale në Glogovc C.nr.64/2002 i dt.15.maj 2003.Sipas këtij aktvendimi J. H.i është refuzuar kërkesa për pengim të posedimit të bërë nga N.B.në ngastrën që është objekt i kërkesës. N.B. ngastrën 627/2 e shfrytëzon nga viti 1985/86. Duke qen se aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.362/2007 i dt.26 shkurt 2008 është anuluar aktvendimi që i referohet kësaj çështje juridike, ndaj edhe kontesti është i hapur.

Arsyetimi ligjor:

10. Sipas Nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të amandamentuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave të cilat lidhen me pronën e paluajtshme, duke përfshirë këtu pronën bujqësore dhe atë komerciale, pala mund të ushtrojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh pas njoftimit mbi vendimit.
11. Ankesa është e pranueshme edhe pse pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurën para KKPK-së. Kjo rrethanë nuk mund të shkoj në dëm të palës ankuese pasi që në të vërtetë ai nuk ka qenë si duhet i njoftuar në lidhje me kërkesën. Njoftimi është bërë përmes publikimit të kërkesës në Gazetën Njoftuese të AKP-së dhe në Buletinin e UNHCR-it. Kjo, megjithatë, përbën “përpjekjet e

arsyeshme” për të njoftuar në lidhje me kërkesën siç parashihet me nenit 10.1 të rregullores vetëm në rastet e jashtëzakonshme. Një rast i tillë nuk mund t’i referohet rasteve të jashtëzakonshme. Pasi që gjykata nuk mund të përjashtoj se pala ankuese nuk ka qenë në dijeni në lidhje me kërkesën, ai duhet të pranohet si palë në procedurë ,ndaj edhe ankesa e tij është e pranueshme.

12. Përpos kësaj ,në shkresat e lëndës nuk ka prova të sigurta se pala përgjegjëse në kërkesë-ankesë ka marr njoftim për kërkesën e paraqitësit të kërkesës për pronën private ,prandaj edhe në këtë fazë të procedurës i pranohet cilësia e palës ankuese i cili ka interes ligjor në këtë çështje juridike të vërtetimit të pronësisë sipas parashtruesit të kërkesës.
13. Gjykata Supreme konkludon se vendimi ankimor i KKPK është marr me shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 182 par 2 nëpar b të LPK-ës dhe nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, të cilat shkelje janë të natyrës absolute e për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare .Prandaj ,mbi këtë bazë juridike vendimi ankimor anulohet duke hedhur kërkesë padinë e paraqitësit të kërkesës për shkak të mungesës së juridiksionit të kësaj gjykate dhe rrjedhimisht të KKPK-ës sipas dispozitës së nenit 198 par 1 të LPK-ës.
14. Sipas nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i KPCC përjashtohet nëse procedimi gjyqësor ka filluar para datës 16 tetor 2006,datë kur ka hyrë në fuqi UNMIK-ut 2006/50.Pasi që procedimi gjyqësor në lidhje me pronën e kërkuar ka filluar në vitin 2003, që rezulton nga aktvendimin e Gjykatës Komunale në Glogovc C.nr.64/2002 i dt.15.maj 2003,ndaj edhe kjo kërkesë nuk është në juridiksionin e KPCC dhe rrjedhimisht të Gjykatës Supreme.
15. Rrjedhimisht, vendimi i KKPK-së ankimor është dashur të anulohet dhe kërkesa të hedhet poshtë (neni 13 par3 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079)

Këshillë ligjore:

Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it